

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kush fshihet pas kokainës në Portin e Durrësit, gjurmët që të çojnë te “Gjenerali” - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/kush-fshihet-pas-kokaines-ne-portin-e-durresit-gjurmet-qe-te-cojne-te-gjenerali/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 15:48:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 15:33:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8380ecde242b2fcf4ef0c3eaba761ba61736d1c92f8b65b0ab7e1f383e2dbbe0
TEKSTI	645bf4a3226d4287ff219df6af7c5989e4817b0ca2bc085a5c137e9b1e6da6dc
PAMJA	474a31cd15d61f83b475fb8de55e48c06a7ef58fe48f7c8af3b1e2af5a06491d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7c2afdcd6c2d832cb50f7d034fe9c7ddf69b1dd9c0e775629d857fa5080f8428
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	732ea03e09e76f3f4c4f7148212f99ed57cacfcbea6b7c5016ac103a159e81ab
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7c2afdcd6c2d832cb50f7d034fe9c7ddf69b1dd9c0e775629d857fa5080f8428>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Kush fshihet pas kokainës në Portin e Durrësit, gjurmët që të çojnë te “Gjenerali”

by Bota Bota — September 15, 2026 in Aktualitet, Kronikë, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga sekuestrimi i **41 kilogramëve kokainë** në Portin e Durrësit, të gjetura në një kontejner frigoriferik që transportonte mish pule nga Brazili drejt Shqipërisë.

Ngarkesa u zbulua gjatë kontrolleve në port, ndërsa droga ishte fshehur në pjesën e jashtme të kontejnerit. Sipas të dhënave të bëra publike, kontejneri kishte nisur udhëtimin nga Brazili dhe, përpara mbërritjes në Shqipëri, kishte kaluar tranzit edhe përmes Greqisë. Ngarkesa me mish pule ishte porositur nga kompania **AMG Food**, në pronësi të **Mondi Goxhajt**.

Por sipas **raportimeve në media**, sekuestrimi në Durrës është kryer në të njëjtën ditë me një operacion të zhvilluar në Belgjikë kundër një grupi shqiptar të dyshuar për trafik ndërkombëtar kokaine.

Prokuroria e Antwerp-it ka konfirmuar se hetimi ndërkombëtar, i zhvilluar në bashkëpunim me autoritetet e disa shteteve dhe Europolin, ka prodhuar rezultate edhe jashtë Belgjikës. Sipas zëdhënësit të Prokurorisë së Antwerp-it, Kristof Aerts, një prej rezultateve të këtij bashkëpunimi ishte edhe sekuestrimi i **37 kilogramëve kokainë** në Shqipëri, të fshehura në një kontejner frigoriferik.

Autoritetet belge kanë arrestuar tetë persona në kuadër të këtij hetimi. Mes tyre është edhe një shqiptar 48-vjeçar, i cili dyshohet se kishte rol ndërmjetësues mes grupeve kriminale në Shqipëri dhe rrjeteve të trafikut të kokainës në Amerikën Latine.

Sipas hetuesve belge, 48-vjeçari dyshohet se siguronte kontakte për importimin e sasive të mëdha të kokainës përmes portit të Antwerp-it, ndërsa komunikimet e tij dyshohet se shtriheshin edhe te grupe të tjera kriminale në Evropë dhe deri në Australi.

Identiteti i 48-vjeçarit nuk është bërë publik, por në kuadër të hetimit janë evidentuar kontaktet e tij me **Gerd Gjinararin**, i njohur me nofkën **“Gjenerali”** dhe i arrestuar në Belgjikë në muajin qershor.

Megjithatë, deri në këtë fazë nuk ka një konfirmim zyrtar nga autoritetet shqiptare se Gerd Gjinarari, i njohur si “Gjenerali”, ka lidhje me kokainën e sekuestruar në Portin e Durrësit. Lidhja mes dy ngjarjeve mbetet në kuadër të dyshimeve dhe verifikimeve që pritet të kryhen gjatë hetimit.

Po ashtu, deri më tani nuk është bërë i ditur asnjë arrestim në Shqipëri në lidhje me 41 kilogramët e kokainës së sekuestruar në port.

Tags: AMG FOOD gerd gjinarari Kokainë Porti i Durrësit

TË FUNDIT

Kush fshihet pas kokainës në Portin e Durrësit, gjurmët që të çojnë te “Gjenerali”

SEPTEMBER 15, 2026

“Diplomacia e dollarit” vjen në Shqipëri/ Si u hapën dyert për Kushnerin

SEPTEMBER 15, 2026

Aksidenti i rëndë në Dibër, plagosen 5 persona, 4 prej tyre nisen drejt Tiranës

SEPTEMBER 15, 2026

Analiza: Pse partitë e konsoliduara në Gjermani po humbasin votuesit migrantë?

SEPTEMBER 15, 2026

Faza e dytë e regjistrimit/ “Çorbë” në U-Albania, ç’aktivizohet opsioni i “kuotave të lira”

SEPTEMBER 15, 2026

Emmy Awards 2026/ Matthew Rhys fiton dy trofe dhe hyn në histori, lista e plotë e fituesve

SEPTEMBER 15, 2026

245 aplikime për të punuar me “agjencinë e propagandës së regjimit”

SEPTEMBER 15, 2026

“Më premtoi vend pune”, 35-vjeçarja denoncon dajën e deputetes Zegjine Çausi për përdhunim

SEPTEMBER 15, 2026

Marshim në Milano në mbështetje të protestave në Tiranë, pritet pjesëmarrje edhe e eurodeputetëve

SEPTEMBER 15, 2026

Vuçiç largohet nga Presidencia, por rikthehet në garën për kryeministër

SEPTEMBER 15, 2026

Previous Post

"Diplomacia e dollarit" vjen në Shqipëri/ Si u hapën dyert për Kushnerin



Bota Bota

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin

0 SHARES



Identifikohet shqiptari i vrarë në Itali/ E lidhën dhe e ekzekutuan në makinë, automjetin më pas e hodhën në lumë

0 SHARES

© 2025 REPORT.AL

Aktualitet / OP-ED / Politike / Rajon / Showbiz / Sociale / Shëndet / Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.